

RAPORT PARAPRAK PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

OBJEKTI:

RIKONSTRUKSION DHE NDERTIM I HEC ÇARÇOVË

VENDNDODHJA E ZONËS SË ZHVILLIMIT:

NJESIA ADMINISTRATIVE ÇARÇOVË, BASHKIA PERMET

Porositës: Shoqeria "KENXHI" SHPK

Hartoi: "Green Eagle Consulting" sh.p.k.
Studio Mjedisore
Nr. Licence 4874-04-2018



TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN RAPORTI PARAPRAK I VNM

Hyrje

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR.....	3
2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.	4
3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.	10
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....	18
5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....	21
6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.	22
7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS 	22
8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	23
9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.	24
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....	26

HYRJE

Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit "KENXHI SHPK", me administrator Z. Tomor Spahiu dhe NIPT: K59418210Q. Ky subjekt, rezulton se eshte pronar i HEC Çarçovë dhe ka fituar te drejten per kryerjen e punimeve te rikonstruksionit dhe ndertimit te HEC Çarçovë, i cili eshte ne gjendje te amortizuar dhe jofunksional. Objekti i vleresimit te ketij raporti te VNM eshte projekti per kryerjen e punimeve te rikonstruksionit te HEC Çarçovë me kanal derivacioni 1284ml dhe ndertimin e nje godine tjeter HEC me nje kanal derivacioni rreth 950ml.

Te dhenat teknike te ketyre dy mini-heceve jane:

Fuqia e instaluar e hidrocentralit Çarshovë, me pellg ujëmbledhës 82.6 km² do të jetë =786 kw.(226 kw+ 560 kw)

Harta topografike e shkalles 1:25,000, me nomenklature: K-34-138-C-a



Koordinatat në sistemin Gaus-Kruger për HEC Çarçovë						
	HEC Çarçovë 1/1			HEC Çarçovë 1/2		
	Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X	Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
Vepra e Marrjes	1	4461900	4444825	1	4461400	4443900
Godina e HEC.	2	4461400	4443900	2	4461000	4443175

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011;

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjive të propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimit të pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet perberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerëzore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".
- Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011, "për vlerësimin e ndikimit në mjedis"
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit".
- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar të mbetjeve".
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit".
- Ligji Nr. 9244, Date 17.06.2004 "Per mbrojtjen e tokës bujqesore"

- Ligji Nr. 5/2016 datë 4.2.2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr. 138/2013 datë 2.5.2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme"
- Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".
- Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 Per zhvillimin e procedures se VNM-se.
- Vendim i KM Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".
- Vendim i KM Nr.1631, datë 17.12.2008 "Për shpalljen "Park Kombëtar" të Ekosistemit Natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar"
- Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave.

Shenim:

Bazuar ne Ligjet e mbrojtjes se mjedisit, ky projekt nuk perfshihet ne listat e aktiviteteteve te cilat duhet te paisen me leje mjedisore te tipit A, B ose C.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet vetem per fazen e kryerjes se punimeve te ndertimit, largimit te bimesise dhe hedhjes se dheut qe do te depozitohet. Gjate fazes funksionimit nuk ka ndikim domethenes ne mjedis dhe per me teper do te kryhen punime rehabilituese, por gjithesesi ligji parashikon qe para fillimit te punimeve, ky projekt duhet ti nenshtrohet procedures paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, sipas shtojces II, pika 3. Ë. Ky raport paraparak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, sipas kerkesave dhe detyrimeve ligjore, mund te paraqitet ne Agjencine Kombetare te Mjedisit per tui nenshtruar procedures paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, sipas kerkesave te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 Per VNM, Shtojca II, si dhe hartohet ne perputhje te plote me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Zona në të cilën ka nisur rikonstrukcioni i HEC-it është tërësisht një zonë pyjore, në të cilën kryesojnë mbulesat e shkurreve mesdhetare në përbërjen e të cilave ka lloje gjethembajtës dhe lloje gjëtherënës. Sidoqoftë, e vështruar në pamjen e përgjithëshme dhe, njëkohësisht duke i'u referuar përqindjeve të pjesmarrjeve të llojeve në mbulesat shkurre, vlerësojmë se bimësia pyjore e zonës së Çarçovës bën pjesë tërësisht në brezin e makies mesdhetare; ky brez fitosociologjik dallohet nga dendësia e madhe e mbulesës shkurre si dhe nga gjelbërimi gjithvjetor i saj.

Llojet kryesorë përbërës të këtyre mbulesave janë: Krifsha e ndërmjetme (Phillyrea media L.), Bulgri (Quercus trojana Webb.), Vidhi (Ulmus campestris L.), Lofata (Cercis siliquastrum L.) Gorrica (Pyrus amygdaliformis Will), Mëllagjeri (Arbutus andrachne L.), Marja (Arbutus unedo Edulis Hifimgg et Lk.), Qarri (Quercus cerris L.) Ilqja (Quercus ilex L.), Dëllënja e Kuqe (Juniperus oxycedrus L.), Prralli (Quercus coccifera L.), Shqopa (Erica arborea L.), Fshikëkartha (Colutea arborescens L.), Shkoza e Zezë (Carpinus orientalis Mill.)...

Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të mbulimit sipërfaqësor të ekosistemit pyjor si dhe në drejtim të përqindjeve të pjesmarrjes së llojeve të cituar më lart *) është arritur në përfundimet e mëposhtëm:

- *Phillyrea media*25%
- *Quercus ilex*.....25%
- *Juniperus oxycedrus*.....15%
- *Arbutus andrachne*.....15%
- *Arbutus unedo*.....10%
- Të tjerat.....10%

Në skarpatet e zhveshura ose gjysëm të zhveshura gjenden të përhapur llojet e shkurrëzave të gjinisë *cystus* (përkatësisht: *C. incanus*, *C. salviafolius*).

Bimësia barishtore

Krahas bimësisë shkurre të përshkruar më lart, në zonën e Çarçovës, rriten gjithashtu bimë barishtore të cilat janë lloje të veçantë për kushtet klimatike e tokësore të ekosistemit në fjalë. Ie të citojmë disa që janë kryesorë në këtë mjedis natyror:

Telishi (*Dactylus glomerata* L.), Bishtpelëza e livadheve (*Festuca pratensis* Huds.), Rudithi i pyjeve (*Brachypodium silvaticum* (Huds.), Këlkaza (*Arum italicum* Mill.), Gjethe Delli gjethe ngushtë (*Plantago lanceolata* L.), Luleshqerra e pyjeve (*Bellis sylvestris* Cyr.), Mentja (*Mentha* sp.).

*) Vlerësimi i përqindjeve të mbulesave dhe përqindjet e pjesmarrjes së llojeve u bënë me sy të lirë, bazuar në eksperiencat e shumta të ekspertit.


Peizazhi

Zona e Çarçovës ka një peizazh mjaft të bukur, kjo për arsye se ajo përbëhet nga kodra me forma e madhësi të ndryshme, ndërsa në horizontet gjeografikë të anës perëndimore dhe asaj lindore ngrihen male e vargmale të cilët i japin peizazhit një bukuri madhështore (Mali i Nemërçkës dhe Mali i Postenanit). Mespërmes, peizazhi përshkohet nga shtrati i lumi të Vjosës në të cilin derdhen prrej e lumej të tjerë që burojnë nga malet rreth e rrotull. Natyra ka ndërthurur të gjithë elementët gjeografikë në hapsirën e kësaj zone, aty shtrihen fusha dhe livadhe të blertë në sfondin të të cilëve dallohen vendbanimet e komuniteteve autoktonë; Një peizazh mjaft shlodhës me bukuri magjepsëse.

Pamje satelitore te zones dhe vegetacionit pyjor




Foto te zones se zbatimit te projektit





Pamje satelitore e zones ku do te zhvillohet aktiviteti



Kanali Derivacionit HC 1/1 eshte 1284ml.

Kanali Derivacionit HC 1/2 eshte 950ml.

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit "Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë" u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull.

Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar "Mali i Dajtit" dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25.

Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Lagunat Bregdetare

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përkrah të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojë, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel, Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë. Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tynelët e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës. Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vjetët e fundit.

Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlsh për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zbatimit te ketij projekti ka burime ujore te rëndesishme te identifikuara. Burimi ujqor me i afert dhe i rëndesishem i kesaj zone eshte pikerisht Perroi i Çarçovës dhe Lumi Vjosa, ne te cilin derdhet ky Perrua. Perroi i Çarçovës ndodhet fiks ne vepren e marrjes dhe godinen e HEC-it te ketij projekti, ndersa Lumi Vjosa ndodhet rreth 1 km larg nga pika me e afert e ketij projekti. Burime ujore te tilla si Liqene, Laguna apo zona Bregdetare ndodhen larg kesaj zone objekt vleresimi.

Pamje satelitore e zones dhe burimeve ujore



Pamje te burimit ujqor te zones (Perroi i Çarçoves)



Pamje te burimit uhor te zones (Perroi i Çarçoves)



Vepra e marrjes se HEC ekzistues



Pamje e Lumit Vjosa ne zonen e Çarçoves



Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike.

Zona në vlerësim bënte pjesë në sipërfaqen e zonës me status Park Kombëtar (Bredhi i Hotoves-Dangelli), e cila ka status mbrojtjeje nga Ministria e Mjedisit. Siç shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim ndodhet brenda sipërfaqes së zonës së mbrojtur por fiks në kufirin e zonës, pra vetë Perroi i Çarçovës është kufiri i zonës së mbrojtur dhe kjo zonë kufitare ka statusin Zone e zhvillimit të qendrueshem. Për një pasqyre me të plotë, Zonat e mbrojtura të rajonit citohen më poshtë:

Monumentet Natyrore te Rrethit Permet.(Sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Rapi i Megallares- afer fshatit Gjinakar	16	Bokerimat e Dangllise
2	Pylli i Gerhotit, afer fshatit Zhepe	17	Gropa e Kazanit
3	Bredhi i Çarshoves se Vjeter	18	Guri i Petranit
4	Rrapi i Zhepes	19	Kanioni i Kamenikut
5	Pylli i Çukes	20	Ujevara e Sopotit afer fshatit Sterbec
6	Pylli i Ropushes	21	Ujrat Termale te Benjes
7	Horizonte vithisese dhe olistolite – Çarçove	22	Uji i Zi Kelcyre
8	Perendi e Borockes (Kanioni, Guri i Bletes)	23	Rrepet e Grykes se Kelcyres
9	Pusi i Cilikojkave afer fshatit Çorrogunj	24	Bredhi i Petranit
10	Pusi i Nemerçkes	25	Selvia e Kishes – Leuse
11	Shpella e Pellumbave	26	Grumbulli pyjor i Polmenit (rap+arre)
12	Cirku i Nemerçkes	27	Rrepet e Kuçarit
13	Guri i Qytetit	28	Bredhi i Kokojkes Frasher
14	Guri i Atos – afer fshatit Kutal	29	Arra e Llukanit-Frasher
15	Kanioni i Lengarices	30	Geshtenja e Teqese Frasher

Ne rajonin ne vleresim, zona e mbrojtur me e afert me projektin ne vleresim eshte Parku Kombetar "Bredhi i Hotoves-Dangelli", i cili ndodhet me zonen qender ne Frasher.

Vendim i KM Nr.1631, datë 17.12.2008 "Për shpalljen "Park Kombëtar" të Ekosistemit Natyror Bredhi i Hotovës-Dangëlli me sipërfaqe të zgjeruar"

Kufijtë "Parku kombëtar", janë si më poshtë vijon:

a) Veri:

Kuota 1 291,3 m (Maja e Qarrishtës), me koordinata 4 439 461 V dhe 4 469 277 L, vijon përgjatë kurrizit dhe ndjek rrugën vendore, në krah të fshatit Sevrani i Madh, me kuotën 758 m, kalon pranë burimit Gurra e Kafshit, ndjek rrugën vendore dhe kurrizin ujëndarës, me kuotën 1 246,8 m (Maja Sheshi i Mukalisë), vijon me rrugën dhe kuotën 1 254 m, ndjek rrugën dhe zbret kurrizin në drejtim të Përroit të Kreshovës, pasi ndërpret përroit i ngjitet kurrizit, kalon në digën e rezervuarit, vijon në drejtim të kuotave 1 571 m, 1 232 m, 1 074 m, 835 m, 845 m, ndërpret Përroit e Miçanit, kuota 1 078 m, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1 404 m, 1 503 m, 1 588 m, 1 585 m, 1 827,6 m, 1 663,2 (Maja e Qelqit), ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1492 m deri te Qafa e Dëllinjës (1 356 m), me koordinatat 4 455 559 V dhe 4 471 253 L.

b) Lindje:

Kuota 1 356 m (Qafa e Dëllinjës), me koordinatat 4 455 559 V dhe 4 471 253 L, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 1 396 m, 1 345,5 m, 1 343 m, 1 431 m, zbret kurrizin në drejtim të kuotës 1 286 m (Maja e Golemasit), ndjek kurrizin Faqja e Gremës, kuotat 1 003 m, 913 m, në pikën e takimit të përroit të Selenicës me përroit e Zavalanit, kuotat 1 061 m, 882 m (maja e Prasqopit), kuota 778 m, kalon te pika e takimit të përroit të Zavalanit me përroit

Guri Pelpel, kuota 881 m, ndjek rrugën vendore deri te pika e takimit të përroit Burimi i Krimbur me Përroit e Virit, më pas vijon përgjatë lumit të Anit, kuota 575 m, me lumin e Gostivishtit, me kuotat 479 m, 433 m deri te pika e takimit të lumit të Gostivishtit me lumin e Lengaricës, vijon përgjatë lumit të Lengaricës, në drejtim të kundërt të rrjedhjes, deri te pika e takimit me përroit e Gradishtës, ngjitet kurrizit, kuota 1 110 m, ndjek rrugën vendore, kuota 1 106 m, vijon përgjatë kurrizit Faqja e Lajthizës, në kuotat 1 357 m, 1 382 m, 1 321,5 m, 1 336 m, 1 441 m, 1 477 m, 1 553,4 m (Maja e Postenanit), 1 507 m, 1 523 m, 1 481,9 m, Qafa e Postenanit, 1 488 m, 1 472,7 m, 1 371 m, zbret kurrizin Gryka e Pagmentit deri te pika e takimit të lumit të Çarshovës me përroit e Postenanit, me koordinata 4 463 360 V dhe 4 447 984 L.

c) Jug:

Pika e ndërprerjes së lumit të Çarshovës me përroit e Postenanit, me koordinata 4 463 360 V dhe 4 447 984 L, ndjek rrjedhjen e lumit të Çarshovës në drejtim të lumit Vjosë deri te ura e Çarshovës, me koordinata 4 460 893 V dhe 4 442 781 L.

ç) Perëndim:

Ura e Çarshovës, me koordinata 4 460 893 V dhe 4 442 781 L, ndjek krahun e djathtë të rrugës automobilistike Çarshovë-Përmet, deri te kryqëzimi i rrugës për në fshatin Benjë, kuota 292 m, më pas ngjitet kurrizit të pyllit të Pomecit, kuota 451,1 m (Maja e Malit të Bardhë), ndjek rrugën vendore dhe kuotat 471 m, 558 m, përsëri me rrugën vendore dhe kurrizin Bregu i Madh, Maja e Qytezës, kurrizin mbi fshatin Qilarisht e Vogël, kuotat 636 m, 771 m, 1 028 m, 1 128 m (Hija e Plepit), zbret kurrizin dhe kalon në Qafën e Ajdinit, ndjek rrugën vendore dhe kuotat 928,7 m, 928 m (Guri i Thanëve), zbret kurrizin dhe ndjek rrugën për këmbësorë, kuotat 404.0 m, 451.0 m (Maja e Sukës), ndërpret përroit e Muzhdinës, vijon në krahun e majtë të rrjedhës së kanalit ujitës, kuota 276.0 m (Maja Guri i Kosinës), ngjitet kurrizit në krah të fshatit Kosinjë, kuota 296.0 m, 342.0 m, ndjek rrugën për këmbësorë mbi Kosinë, ura e përroit të Hotovës, kuota 231 m, ndërpret lumin e Lumnicës dhe përroit e Kalenjave, ngjitet kurrizit në kuotat 292 m e 332 m, ndjek rrugën vendore për në fshatin Pacomit (Kalenjë), vijon me rrugën në drejtim të kuotës 988,7 m (Maja e Kokoresit), përsëri me rrugën dhe kuotat 1 025,6 m (Maja e Seniçanit), 1 035 m, 1 038 m, 1 264 m, kalon në kufi të pyllit të Hijës së Sharrës dhe kuota 1 291, 3 m (Maja e Qarrishtës), me koordinata 4 439 461 V dhe 4 469 277 L.

“Parku Kombëtar” Bredhi i Hotovës-Dangëlli ka një sipërfaqe të përgjithshme 34 361.05 (tridhjetë e katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje zero pesë) ha, ku pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet pyjore, të ndjekura nga sipërfaqet kullosore, bujqësore, joproduhuese, shkëmbore dhe sipërfaqe troje, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

“Parku kombëtar” Bredhi i Hotovës-Dangëlli ndahet në katër nënzona ruajtjeje e administrimi, si më poshtë vijon:

a) Zona qendror, me sipërfaqe 2 888.69 ha (e shënuar në hartë me “ZQ”), përfshin habitatet kryesore natyrore të Bredhit të Hotovës. Ajo përcaktohet si zonë me vlera të larta, për natyrën dhe biodiversitetin dhe në të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar.

b) Zona e përdorimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe 18 922.50 ha (e shënuar në hartë me “ZPQ”). Në këtë zonë përfshihen habitate, pyjore e kullosore, pothuajse përreth zonës qendrore, për të cilën ajo shërben si zonë buferike.

Në këtë zonë lejohen veprimtaritë ekonomike sezonale (si kullotja, grumbullimi i bimëve mjekësore, prodhimeve të dytë të pyllit), të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit dhe ushtrohen vetëm me leje mjedisi. Në zonën e përdorimit të qëndrueshëm zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

c) Zona rekreative, me sipërfaqe 80.28 ha (e shënuar në hartë me "ZR"), përbën zonën me mundësi rekreative, në natyrë të hapur, në përputhje me funksionet e zonës së mbrojtur, vlerat ekologjike, të peizazhit dhe vlerat turistike e kulturore. Në këtë zonë përfshihen pjesët pyjore, livadhet dhe toka bujqësore në masivin pyjor të Bredhit të Hotovës dhe banjat termale. Në zonën rekreative zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

ç) Zona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe 12 469.58 ha (e shënuar në hartë me "ZPT"), mundëson vazhdimin e veprimtarive tradicionale dhe ekonomike, dhe në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari të reja, vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi, dhe, për rastet e trashëgimisë kulturore, me leje nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe shërbimi arkeologjik. Në këtë zonë përfshihen territoret bujqësore, ujore e disa toka, me bimësi pyjore, ato rreth qendrave të banuara, kryesisht të përdorura nga banorët. Në zonën e përdorimit tradicional zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

Administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur dhe e sektorit pyjor të qendrës (DSHP Përmet) kryejnë funksionet e administratës së "Parkut kombëtar" Bredhi i Hotovës-Dangëlli.

Sasia e sipërfaqeve, sipas përbërjes

Tabela

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja në ha
1.	Sipërfaqe pyjore, pyje të përzier (bredhi, al, pishë, dushk), shkurre, ripyllëzime, tokë me bimësi pyjore	24 612.02
2.	Sipërfaqe kullosore e livadhe	714.14
3.	Sipërfaqe bujqësore (arë, pemëtore, vreshta)	5 292.83
4.	Sipërfaqe ujore (lumenj, përrenj, rezervuarë)	25.48
5.	Sipërfaqe joproduhese (shkëmbore, e zhveshur)	3 307.84
6.	Sipërfaqe urbane dhe troje të përziara me tokë bujqësore dhe pyjore	408.74
	Sipërfaqe e përgjithshme	34 361.05



4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:


- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

Ndikime te rendesishme gjate punimeve te ndertimitdhe rikonstruksionit te HEC Çarçove Shkarkime ne uje

Ndertimi dhe rikonstruksioni i ketij HEC-i do te shoqerohet me disa impakte mjedisore te cilat konsistojne kryesisht ne demtimin e bimesise dhe germimin e dheut per hapjen e trasese se kanalit te derivacionit i cili perfshin kanalim dhe rrugen automobilistike. Ky kanal do te kete nje gjatesi prej rreth 1284 ml dhe 950ml, si dhe nje gjeresi ne total prej 4.4m. Keto punime duhet te shoqerohen me masa rehabilituese, duke ngritur prita ose gjerdhe prej druri ne anen e skarpates se poshteme ne menyre qe dheu i germuar te mos perhapet ne mjedisin e zones e me tej ne Perrua por te grmubullohet ne skarpate e poshteme dhe te kryhet rehabilitimi i plote i tij. Ne kete menyre, reduktohet ndjeshem efekti i erozionit , depertimi i dheut ne burimin ujqor dhe efekti ne peizazh. Ndikimet ne uje nga funksionimi i Hec-it do te jene devijimi i rrjedhes se ujit dhe reduktimi i sasise se ujit ne perrua.

